



Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

KUVENDI I ODËS SË FIZIOTERAPEUTËVE TË KOSOVËS (OFTK), në mbledhjen e mbajtur online në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1 dhe 1.17 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150 dhe nenit 21, paragrafi 1 dhe 22 të Statutit të OFTK-së, me datë: 15.02.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Lirimi nga taksat për provim të Rilicencimit në OFTK për të gjithë anëtarët e OFTK-së të cilët posedojnë licencë të skaduar e cila si e tillë është jo valide para datës 01/01/2021.
- II. Lirimi nga taksat për provim vlenë vetëm për anëtarët nga paragrafi I-rë të cilët kërkesën e tyre për provim e paraqesin nga data **15.02.2024** deri me **15.03.2024**.
- III. Anëtarët të cilët nuk respektojnë afatin nga paragrafin paraprak, paguajnë sipas sistemit të rregullt të taksave për shërbimet e OFTK-së.
- IV. Vendimi u mor online me shumicë votash.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim - Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës me qëllim të stimulimit të anëtarëve të saj për tu pajisur me licenca valide dhe plotësimin të kushteve ligjore për ushtrim të veprimtarisë nxjerr këtë vendim për lirim nga taksa e provimit të rilicencimit në OFTK për kategoritë e anëtarëve të cilët është skaduar licenca para vitit 2021, vit ky nga i cili ka filluar edhe organizimi i provimit për rilicencim në OFTK. Vendimi në fjalë përfshijnë vetëm taksën për provim të rilicencimit, ndërsa të gjitha detyrimet tjera përfshirë anëtarësimin, licencimin dhe rilicencimin janë të detyrueshme edhe për këtë kategori.

I'dërgohet:

Komisionit për Anëtarësim, Licencim dhe Ri-licencim/OFTK
Shërbimit Profesional të OFTK-së

Prishtinë, 15.02.2024

Kryetari i Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës
Ass.MSc.Feim Gashi PT

